



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli i Ministrave**

**V E N D I M**

Nr. 442 , datë 16.6.2011

**PËR**

**MIRATIMIN E KUSHTEVE, TË DOKUMENTEVE VËRTETUESE,**  
**TË AFATEVE TË VLEFSHMËRISË DHE TË PROCEDURAVE**  
**TË SHOYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR AUTORIZIMIN E TREGTIMIT**  
**TË MINERALEVE TË ÇMUARA DHE GJYSMË TË ÇMUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32, pika 2, e 56, pika 1, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Për kryerjen e tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara personat juridikë, vendas dhe të huaj, të regjistruar si të tillë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), duhet të pajisen me autorizimin përkatës.
2. Dhënia e autorizimit të tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara personave juridikë bëhet nga ministri përgjegjës për veprimtaritë minerare në përputhje me kërkesat e nenit 32, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.
3. Autorizimi për tregtimin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara jepet me afat vlefshmërie deri në 10 (dhjetë) vjet, nga data e hyrjes në fuqi, me të drejtë deri në 2 (dy) vjet, me kusht që kjo shtyrje afati të kërkohet nga zotëruesi i


autorizimit të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

4. Dokumentacioni i plotë i kërkesës për autorizim për tregtimin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara paraqitet në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN). Data e aplikimit shpallet në web site-in e këtij institucioni.
5. Dokumentacioni i plotë i kërkesës për autorizim për tregtimin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, i cili shqyrtohet dhe vlerësohet nga AKBN-ja, duhet të përmbajë:
  - a) ekstraktin e vendimit të QKR-së për regjistrimin, si person juridik, ku në objektin e veprimtarisë të këtë të miratuar edhe zhvillimin e aktivitetit të tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara sipas kërkesës;
  - b) një përshkrim të kapaciteteve profesionale dhe menaxheriale të kërkuesit që i vlejné atij për realizimin e veprimtarisë së tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, si dhe një përshkrim të përvojës së tij të mëparshme në këtë fushë, nëse ka;
  - c) të dhëna për burimet financiare të nevojshme për realizimin e kësaj veprimtarie;
  - ç) specifikim të mineralit/mineraleve për të cilat kërkohet autorizimi;
  - d) një informacion për tregjet e mundshme të shitjes së këtyre mineraleve dhe për kontratat paraprake të lidhura për këtë qëllim, nëse ka;
  - dh) vërtetimin nga organet përkatëse që nuk është fajtor për asnjë vepër penale, cilësuar si e tillë pas një procesi të plotë gjyqësor, që lidhet me veprimtarinë e tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara. Për shoqëritë e huaja, një vërtetim të tillë nga vendi i origjinës.
6. AKBN-ja, pasi e shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e plotë për autorizimin për tregtimin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, por jo me vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas marrjes së aplikimit, e dërgon atë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), së bashku me mendimin me shkrim për dhënien ose jo të autorizimit, të nënshkruar nga titullari i saj.
7. Ministri, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e aplikimit në AKBN, nxjerr aktin e dhënies ose të mosdhënies së autorizimit për tregtimin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara. Në këtë rast, nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje. Forma e autorizimit përcaktohet në rregulloren që miratohet nga ministri.

8. Kërkuesi njoftohet për miratimin ose jo të kërkesës me shkrim nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe nëpërmjet publikimit në web site-in e saj.
9. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.


**KRYEMINISTRI**



**SALI BERISHA**

**MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË  
DHE ENERGJETIKËS**

**NASIP NAÇO**



NR.PROT.974/1  
DATË 29.6.2011

MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË  
DHE ENERGJETIKËS  
MINISTRISË SË FINANCAVE  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR  
QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT  
AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE  
NATYRORE  
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHJA  
Sekretari i Përgjithshëm

